Në kufirin gjermano-zvicëran, Brahimit dhe Hysenit u ka zënë policia e huaj disa qindra ekzemplarë të "Bashkimit" dhe ua ka marrë. Me këtë rast, Ibrahimi nuk është treguar i gatshëm për të pranuar kritikat. Përgjithësisht, nëse ia numëron gjestet dhe punët e kritikueshme, ai thotë: "Mos m'u kap vetëm për disa gabime, të vogla". Menjëherë pas kësaj, bashkë me shokët, kanë vazhduar rrugën për në Çekosllovaki, në gjurmim të armëve (ndoshta profesori mund të ketë ndonjë informim nga ana e shokëve të Pragës lidhur me sjelljet e tyre në atë vend, sepse e di që shokët e Pragës kanë pasur kontakte dhe bile disa mosmarrëveshja me ta, sipas fjalëve të I. dhe H.).

Vetë më ka treguar gjoja për disa sugjerime, që i kanë bërë shokët e organizatës së tij në vendlindje, dhe të cilave ai nuk u është përmbajtur fare. Të imponohet përshtypja se as që ka shokë të tillë në Kosovë. Përshtypja e parë dhe e fundit lidhur me këtë çështje është se ai, përveç disa punëtorëve të tubuar rreth tij në botën e jashtme, të paorganizuar po vetëm të furnizuar me literaturë revolucionare dhe të inkurajuar, tjetërkë as që ka prapa vetes. Kjo, edhe në një mënyrë mund të provohet bindshëm. Më vjen një ditë, (vitin e kaluar), në derë me disa shkresurina që vetëm titullin e kishin të qartë: Programi dhe Statuti i Frontit të Kuq Popullor, dhe më lutet t'ia korrigjoj në pikëpamje drejtshkrimore. Më pastaj më autorizon që të preki, po e pashë unë të arsyeshme, „si njeri me përvojë“, edhe në anën materiale të pikave të përfshira në program e statut. Mirë, them, dhe meqë përmbajtja e shkresurinave ishte pa kokë pa bisht, i hy unë punës me gjithë seriozitetin dhe ato pak njohuri që kisha. Gjithmonë kisha parasysh, pas punës sime, ai do t'ua kthente shokëve për diskutim Programin dhe Statutin e Organizatës së tyre. Por, doli ndryshe. Doli se I. K. i ishte tekur të bënte një natë pa gjumë dhe të hartonte këmbadoras një program dhe statut të një organizate revolucionare, të cilin e botoi dhe e shpërndau si „literaturë revolucionare“ menjëherë pas „korrigjimeve“ që i bëra unë. E puna që kisha bërë unë më atë rast, s'ishte punë korrigjimi.

Shokët e Vjenës e mbajnë larg. Bile, kur njërit prej këtyre shokëve, i cili më qortoi pse rrija me I. K., i thash se është një njeri që imponohet me këmbëngulje dhe unë, si shqiptar, nuk mund ta përzë nga shtëpie ime, ky m'u përgjegj fjalë për fjalë kështu: "Ia paske frikën, prandaj s'e përzen si qenin!"

Ka disa muaj që i kam ndërprerë marrëdhëniet me të. Kur takohemi rastësisht flasim, por punë të përbashkëta nuk kemi. Bashkëpunimi me të gjatë demonstratave të mbajtura në Perëndim ka shkuar përmes shokut të "Lirisë".

Kështu e kam parë unë të arsyeshme të veproj, duke marrë për bazë vrojtimet e parashtruara më sipër si dhe disa anë negative në sjelljen elementare të I. K., që herë duken agjamillëk, herë djallëzi të thella.

Përndryshe, një meritë të tij, mendoj nuk mund ta përbuzë askush: që nga viti 1977 e këtej, i vetëm, po me një vitalitet të pashoq, ka bërë shumë në shpërndarjen e literaturës revolucionare, si ka mundur e si ka ditur, dhe në njëfarë politizimi spontan të një pjese të mirë të punëtorëve tanë në botën e jashtme. Është njeri komunikativ dhe i popullarizuar te punëtorët. Udhëton shumë, vlon prej idesh, shpesh naive e të papërpunuara, ndonjëherë edhe të qëlluara.

SOKOLI

(U botua për herë të parë në www.albaniapress.com, 2 tetor 2011 nga Faridin Tafallari, së bashku me punimin *Kur Jusuf Gërvalla shkruante*)

## 6. Letër e Jusuf Gërvallës për Sabri Novosellën, 16 nëntor 1981

16 nëntor 1981

I dashur vëlla Mërgim!

Para tri ditësh t'i nisa një pako dhe tri zarfa me revistën. Po letrën që ta dërgova me to, e shkrova shkurtimisht, se prisja të përfundojë një ngjarje dhe të të shkruaj më gjerësisht.

Të shtunën, më 14 nëntor, në Shtutgart erdhi për të dhënë koncert Orkestrina e Radiotelevizionit të Prishtinës me tetë këngëtarë. Meqë në Shtutgart ende nuk ka klub të shqiptarëve dhe punëtorët e këtushëm, pos me një demonstratë, nuk kanë pasur si ta shfaqin revoltën dhe mendimin e vet lidhur me ngjarjet e Kosovës, ne patëm vendosur ta bojkotojmë koncertin e tyre. Ishte parashikuar nga ana e tyre që, para koncertit, ndonjë politikan të thoshte ndonjë fjalë lidhur me 29 nëntorin (jugosllav). Kurse ne planifikuam që, mes fjalës së tyre dhe koncertit, t'i thërresim punëtorët për dy minuta heshtje në nderim të luftëtarëve të rënë në pranverën e përgjakshme të Kosovës, të lexojmë një tekst të shkurtër (1,5 faqe të shtypura në makinë), të thërresim parullat „Jashtë nga vatrat tona ushtria dhe milicia fashiste jugosllave", „Rroftë populli shqiptar" dhe „Kosova - Republikë", me ç'rast kjo e fundit „Kosova – Republikë" do të vazhdonte pandërprerë deri në ndërprerjen e programit të „mysafirëve".

Por, ngjarjet u zhvilluan shumë më mirë sesa e kishim parashikuar ne. Në këtë drejtim na ndihmuan vetë armiqtë, me nervozën dhe druajtjen e tyre, siç po na ndihmojnë për të na vajtur punët mbarë që nga pranvera.

Konsullata jugosllave kishte organizuar si kujdestarë nja dyzet shqiptarë të mashtruar e serbë, me shirita kujdestarie në duar. Ata duhej të mbanin rend gjatë koncertit. Pas hyrjes në sallë të publikut (nja 5 – 600 veta) dhe të trimave tanë, të organizuar, nja 30 veta, një përfaqësues i ambasadës jugosllave, me emrin Bashkim Hisari (ish punëtor i TV Prishtinës) i afrohen Besnikut dhe një punëtori shqiptar e i nxjerrin nga salla si persona të padëshirueshëm. Meqë Besniku, për shkak të profesionit që ushtron, është i njohur pothuaj për të gjithë shqiptarët e këtushëm, , publiku ngritet i tëri në këmbë dhe reagon për largimin e tij. Atëherë, një shok yni, i LNÇKVSH, e shfrytëzon mirë rastin, hipën energjikisht mbi tavolinë, thërret të madhe parullën „Kosova – Republikë", duke vendosur kështu ta shkurtojë krejt procedurën e planifikuar. Publiku përnjëherë ngrihet i tëri në këmbë dhe i përgjigjet njëzëri parullës. Kujdestarët e neveritshëm dhe personeli i konsullatës jugosllave, me këlyeshët e tyre mercenarë, zënë të tolloviten dhe përpiqen të marrin masa. Por, si vetëtimë u lëshohen në shpinë djelmoshat tanë dhe publiku bashkë me ta. Përfundimi: tragjik dhe komik për armiqtë tanë. Përfaqësuesit të konsullatës i çahet koka me karrige (këtë njeri, Bashkim Hisarin, e kanë rrahur njerëzit tanë edhe në demonstratën e Shtutgartit, se qe treguar shumë i zellshëm dhe dinak e këmbëngulës në realizimin e qëllimeve të poshtra të armikut), e përgjaken të gjithë ata që kanë pranuar të hynë në vallën e tyre. Prej njerëzve tanë e punëtorëve, asnjë i plagosur, as i gërvishur, bile. Në taborin e tyre, disa të plagosur rëndë (ka qenë rrezik që të mbetet edhe ndonjë i vdekur). Fotografia e satrapit Tito dhe flamuri jugosllav grisen e shkilen nga publiku, instrumentat e Orkestrinës fluturojnë, thyhen e shkilen nëpër sallë. Gjatë gjithë kohës, shqiptarët, në përleshje e sipër, nuk e ndalin parullën „Kosova-Republikë". Përleshjet bëhen të rrëmbimshme, të rrufeshme, shumë energjike. Prej salle, i tërë publiku del përjashta dhe, për më se një gjysmë ore rresht, nuk shpërndahet por thërret parulla me zë të lartë, kështu që manifestimi shndërrohet në një demonstratë të shkëlqyeshme. Autobusi i jugosllavëve mbushet me parulla të ndryshme, pëllëmbë për pëllëmbë, me sprej për ngjyrosjen e automobilave. Më në fund, shpërndahen pa therrë në këmbë.

Është interesant të shtohet se policia gjermane, prezente gjatë tërë kohës së përleshjeve, nuk intervenon asnjëherë, por e ndjek ngjarjen me gjakftohtësinë më të madhe. Asnjë punëtor

nuk merret nga policia, as shfaqet fare ndonjë tentim i tillë nga ana e policisë. Disa nga policët gjermanë u bashkohen thirrjeve të parullës „Kosova – Republikë“ dhe u thonë hapurazi njerëzve tanë se kanë të drejtë të veprojnë kështu, sidomos pas nxjerrjes përjashta nga salla të dy njerëzve tanë.

Si e përshkruajnë shokët, ky ishte një manifestim i shkëlqyeshëm i vendosmërisë së punëtorëve tanë dhe i solidarizimit të tyre me bashkatdhetarët në Kosovë. Jugosllavët e pranishëm kanë se çka u tregojnë eprorëve të tyre.

Një shfaqje të ngjashme atyre u kanë organizuar, një javë më parë, edhe punëtorët tanë në Cyrih të Zvicrës. Por, atje, sipas mendimit tim, kanë bërë një gabim të vogël: punën e kanë nisur si kundërshtim ndaj një kënge popullore serbe, të kënduar nga nga një këngëtare serbe. Ndryshe, edhe atje u kanë dhënë mend aq, sa trupa menjëherë e ka ndërprerë turnenë nëpër Zvicër dhe ka kaluar në Gjermani. Në Mynih nuk ka pasur manifestim nga shqiptarët, por ka pasur një lloj bojkotimi. Nga afro 10 mijë shqiptarë që punojnë në atë qytet, në koncert kanë shkuar gjithsej 70 – 80 veta.

Këta rreshta t'i shkrova nën përshtypjen e kësaj ngjarjeje, që neve po na duket me rëndësi.

Tani të njoftoj se bashkë me shokun e „Bashkimit“ dhe të „Lirisë“ kemi vendosur të organizojmë një manifestim qendror për kremtimin e festës kombëtare të 28 dhe 29 Nëntorit në Shtutgart. Do të mblidhemi nja 300-400 veta nga Gjermania, Zvicra e Belgjika. Një pjesë e shokëve do të shkojnë për festë në Vjenë.

Të fala vëllazërore e revolucionare

Sokoli

(Shënim i Xhafer Durmishit: Këtë letër ma dërgoi Kadri Rexha, më 31 gusht 2013)

(U botua për herë të parë nga Faridin Tafallari në www.albaniapress.com, më 1 tetor 2013)

## 7. Letër e Ibrahim Kelmendit për Faridin Tafallarin, maj 1982

Shoku Fahredin,

pasi që në Mercedes janë konvikte, nuk po i dërgojmë atje askujt. Ti do të ishte dashur ta marrësh menjëherë mundin që t'ua dërgosh dhe atyre. Sa për Rrethin tuaj, dihet që do i shpërndash.

Po ta keni mësuar se ku dhe kur do mbahet koncerti do të kishte qenë mirë të bisedohet se çfarë duhet ndërmmarë dhe çfarë kemi mundësi. **Trakti** në fjalë synon informimin e bashkatdhetarëve, që, po që se ndërmarrim ndonjë aksion, të kenë mirëkuptim dhe të mos jenë indifirent; po kështu që përpara, udbashët të dezorientohen, se ne vetëm me bojkotim kemi ndërmend t'i ballafaqojmë e pengojmë.

Për të gjitha, po u duk e arsyeshme kosultimi gojor atëherë mundesh të telefonosh ose të shkruash.

Mirëupafshim

Shoku

(U botua për herë të parë nga Faridin Tafallari, në përmbledhjen me titull: Letra, të dërguara Faridin Tafallarit, nga Ibrahim Kelmendi, www.albaniapress.com, 11 dhjetor 2013)

## 8. Letër e Ibrahim Kelmendit për Faridin Tafallarin, maj 1982

Në mërgim, maj '82 (1982)

I dashur shok,

(Të njejtën letër po ua dërgojme edhe shokëve tjerë.)

traktët aktuale që po merrni duhet shpërndarë sa më parë, pse në prag është turneja, për të cilën bëhet fjalë në trakt.

Taktika e armikut po dihet. Mbi të lëzojmë edhe në **traktin** në fjalë, "**Klika e Beogradit - "të vret natën e të këndon ditën""**. Armiku po synon mashtrimin tonë përmes turneve të këtilla. Kësaj i duhet gjetur ilaçi gjegjës..., prandaj në rrethe duhet të diskutoni me shokë se cila formë është më efektivja për t'ju ndajvuar armikut. Nuk është çasti të bëjmë sehir - në njërën anë të na vrasin, në tjetrën të na mashtrojnë edhe me koncerte, është cinizëm i poshtër. Mendojmë se përmes traktit që keni në dorë është demaskuar armiku, për aq sa është e mundur përmes të një trakti. Por puna tjetër duhet bërë nga shokët në rrethe, pse përvoja na tregon se agjitacioni gojor - traditë popullore - ndihmon më së shumti për t'i sqaruar bashkatdhetarët, që të mos bien në kurthë të armikut.

T'i tregojmë edhe njëherë armikut se jemi bijë e bija të popullit, që nuk biem në kurtha!

Kosova-Republikë! Shokët.

(U botua për herë të parë nga Faridin Tafallari, në përmbledhjen me titull: Letra, të dërguara Faridin Tafallarit, nga Ibrahim Kelmendi, www.albaniapress.com, 11 dhjetor 2013)

## 9. Kush është vojvoda Ramë Nikçi?

Trakt i shpërndarë nga Ibrahim Kelmendi në maj 1982 me titullin:

### KLIKA E BEOGRADIT –
### "Të vret natën, të këndon ditën..."

Sipas informatave të siguruara, ka fundi i majit – për "nder" të "ditës së rinisë jugosllave" (me nder me thën...) dërgohet për të na "argëtuar"... SHKA "Rugova" e vojvodës Ramë Nikçi. Turneja është paraparë në qendrat kryesore të Gjermanisë P., Zvicrës e Belgjikës.

Po kështu jemi të informuar së asnjë shoqëri nuk ka pranuar të ndërmarri turne të këtillë, bazuar në situatën që mbretëron, pos "Rugovës", udhëheqësi "trim" i së cilës ka rrahur gjoks: "Askush nuk do guzon të ma prishë koncertin..." Në fakt shumë shoqëri të afirmuara nuk ekzistojnë më, pse ato kanë kënduar këngë "irredentiste", që kanë "frymëzuar rininë me nacionalizëm shqiptaromadh..."

### Kush është SHKA "Rugova"?

"Rugova" është shoqëri kulturore-artistike (SHKA) e Pejës, anëtarët e së cilës janë rugovasë. Folklori dhe lojrat duhet të jenë me origjinë nga Rugova kreshnike, emrin e së cilës e mban shoqëria.

Në historinë tonë të lavdishme Rugovën e njohim si vend ku armiqët pushtues kanë thyer qafën, siç e thotë edhe kënga: "Ku po i del syni Shqipnisë?/ Del Rugova për derë t'kapisë... ndërsa rugovasit si kryengritës trima në mbrojtje të trojeve, veçmas kundra pushtuesve malazezë në mbarim të shekullit të kaluar dhe në fillim të shekullit tonë, kur mbarë populli luftonte për P a v a r ë s i.

Përkundra kryengritjeve të pandërprera çlirimtare, Rugova me tanë Kosovën u pushtu nga mbretëritë shoveniste të Serbisë të Serbisë e Malit të Zi dhe më vonë, pas Luftës Dytë Botërore u ripushtu...

Bijtë dhe bijat e Rugovës, ashtu si dhe të parët e tyre, vendosën që atdheun t'mos e lënë në robëri të plotë – koloni klasike të të huajve. Në Pranverën Kosovare (1981) u ngritën haptas e me vendosmëri për t'i kërkuar të drejtat elementare, që popujt tjerë të Jugosllavisë i gëzojnë, si që Kosovës t'i njifet Statusi i Republikës së federuar. Emrat e këtyre patriotëve revolucionarë u janë të njohur Kosovës dhe më gjerë, si ai i shokut Ali Lajçi me shokë e shoqe, të cilët edhe në gjyqe tmerruan gjykatësit çetnikë me vendosmërinë dhe revolucionaritetin e tyre. Dënimet e rënda, 10 - 15 vjet burgim të rëndë s'i tremben fare, pse ishin të bindur se kërkesat e popullit janë të drejta dhe duhet të plotësohen.

Sa kreshnike na del Rugova, kur flasim për kryengritësit trima, ndër ta shoku Ali Kelmendi, komunisti i orëve të para, kur flasim për gjithë ata rugovasë, që tani gjenden në kampet jugosllave. Sa shumë ia njollosin emrin Rugovës ca bastardë. Por s’do ia arrinë dotë, pse rugovasit ruajnë me fanatizëm krenarinë se janë nga Rugova! Këtë e bën sidomos vojvoda Ramë Nikçi, përmes SHKA "Rugova", anëtarët e së cilës janë kryesisht të komprometuar, moralisht dhe politikisht, që janë gati të gjithë nga familja e vojvodës dhe farefisit të tij.

## Ç'do të thotë fjala v o j v o d ë ?

Vojvodë është gradë ushtarake në mbretërit serbe e malazeze. Këtë fjalë do ta gjejmë të sqaruar në "ilustrovana politika" të Beogradit. Por për çudi, kur klika serbomadhe ka ndërmarrë fushatë histerike kundra "nacionalizmit romantik" shqiptar, si nuk u bie fjala vojvodë në sy, që nuk ka të bëj vetëm me nacionalizmin serb. Për këtë nuk kanë frikë as gazetari shovenist Zec as vojvoda Ramë, që e përdorin me krenari.

"... Vojvoda rugovas, shkruan "ilustrovana politika" (më 26.05.81), është përfaqësuesi i tanishëm "lozës" (serbisht: loza), e cila që nga kohërat turke ruan qetësinë dhe paprekshmërinë e Patriarkanës...)

Siç na del, vojvodët kanë qenë rojë e rendit, ndërsa vojvodët e familjes Nikçi (nga Shtupeçi i Madh, fshat i Rugovës) kanë qenë rojë besnike e Patriarkanës, të ndërtuar nga Dushani, për ta përjetësuar robërinë e "stara Serbisë" (siç e quajnë shovenistët Kosovën.).

## Kush është vojvoda Ramë Nikçi?

Të shkruajmë se kush është vojvoda Ramë Nikçi nuk e kemi vështirë, pasi ai vetë na e ka lehtësuar këtë, duke përmbledhur historinë e vetë e të familjes në bisedën dhënë "ilustrovana politikës" së Beogradit, Nr. 1177, të 26.05.81. Pos kësaj bisede, ai në rrethin e Pejës është ndër më të komprometuarit. Sa ai është edhe vetëm udbashi rankoviçevës Bajram Dreshi. Të dy së bashku, me ca të tjerë, Rugovës ia njollosin emrin e pa njollosur, pse bijtë e bijat i dalin asaj zot.

Në artikullin e revistës në fjalë, "Besa nije vracena" lexojmë:

"Ramë Nikçi është shef i shërbimit juridik ndërkomunal pranë Entit për Inkuadrim në Pejë..." Siç e pamë më lartë, është përfaqësuesi i tanishëm i "lozës" për ta mbrojtur Patriarkanën.

Në pyetje të gazetarit, se a ka marrë pjesë ndonjë rugovas në demonstrata "nacionaliste", vojvoda përgjigjet: "Po. Të tillëve ju takon sipas ligjit nga qeveria, kurse nga rugovasit – bojkotimi (izolimi). Në shtëpitë s'do hynë askush, dërisa Pleqësia jotë të mos vendos ndryshe. Nga vllazëria ime Nikçi nuk ka asnjë demonstrues. E kam vërtetuar dhe për këtë jap fjalën. Askush nga anëtarët e SHKA "Rugova" s'ka marrë pjesë në demonstrata. Më është bërë qefi..." Pastaj vazhdon vojvoda: "Ishim dy herë si shoqëri mysafirë në RPS të Shqipërisë. Këtë vit shqiptarët është dashur të na e kthejnë vizitën, por le të mos vinë..." Më poshtë vijon vojvoda:

"... Çka u duhet këtyre demonstruesve që kërkojnë t'i bashkangjiten Shqipërisë (...). Këtë liri, siç e kanë shqiptarët në Jugosllavi, nuk e kanë patur asnjëherë askund dhe secili që mendon ndryshe – është njeri i keq..."

Gazetari pyet: "Babën tëndë, gjithashtu vojvodë rugovas, e kanë vrarë në pritë në vitin 1939. Kush dhe përse?"

Ramë vojvoda përgjigjet: "Kanë vrarë babën tim me dy mixhallarë, para syve të mij, brenda gjysmë ore. Ka qenë larje llogarish me fiseve, nuk ka qenë hakmarrje gjaku. U ka penguar (mendohen "vrasësit") pse baba ka qenë vojvodë rugovas, që ka **ruajtur** (nënvizimi ynë) Patriarkanën e Pejës..." Pastaj vojvoda vijon me nostalgji çetnike:

"... Me konakun e vjetër të kishës m'është djegur edhe dhoma në të cilën kam banuar prej 1941-tës e dëri në mbarim të Luftës. Në të ka qenë kërveti, në të cilin kam fjetur, aty ka qenë edhe luga me të cilën kam ngrënë dhe fotografitë e t'parëve të mij. Të gjitha janë djegur..."

Artikulli mbaron me fjalët e vojvodës Ramë: "Unë i **dua** (nënvizimi ynë) shumë fjalët e Mark Milanit..." (Ato s'po i citojmë – Shtojmë se Mark Milani ka qenë komandant i forcave pushtuese malazeze, në luftë për t'i pushtuar Plavë, Gusi, Hot, Grudë e Rugovë...).

E cituam si shumë artikullin në fjalë pse u pa e arsyeshme përmes të kësaj reviste çetnike, gjegjësisht përmes fjalëve të vojvodës, ta njohim udhëheqësin e SHKA "Rugova", i cili, sipas "Pravosllavjes" (Gazetë kishtare serbe", "kur ka parë konakun në flakë ka qa." Vojvoda kësaj radhe "demanton" atë çka ka shkruar "Pravosllavja", duke thën se rugovasit nuk qajnë kur t'u ndodhin fatkeqësi të rënda...

"Patriotizmi" serb i Ramë vojvodës, siç na bind ky artikull dhe profesioni i tij si vojvodë, ia kalon "patriotizmit" serb të shumë çetnikëve, të cilët nuk kanë bërë dhe s'do bëjnë aq sakrifica për ta mbrojtur kishën, sa bëri familja Nikçi (nga Shtupeqi i Madh). Krenaria e Ramë Nikçit si vojvod... për ta mbrojtur Patriarkanën...!!

Duket së nana e Ramës kur ka dashur të kryen nevojë (me nder me then) në vend të m... ka pjellur rastësisht vojvodën...

**Dy fjalë mbi "ilustrovana politikën".**

Pasi cituam si shumë këtë pelenë, duket e udhës t'i themi dy fjalë, pse artikujt tjerë janë vërtetë artikuj të frymës çetnike.

Kjo revistë, bazuar në shkrimet mbi shqiptarët e Shqipërisë, është çetnike e shkuar çetnikëve – edhe më çetnike se ato të emigracionit çetnikë. Për t'u bindur mjafton ta analizojmë numrin në dorë.

Me radhë artikulli i parë mbi Shqipërinë: "Busija mrznje i lazi" (Pusija e urrejtjeve dhe gënjeshtrave"), i cili fillim e mbarim ka qëllim të caktuar – t'i hasmon lexuesit kundra popullit shqiptar e Shqipërisë, atëherë kur është thurur nga shpifjet e trillimet tendencioze.

Artikulli tjetër është: "Ko su albanski terroristi" (Kush janë terroristët shqiptarë"). Në këtë artikull krah plehrave të emigracionit rekcionar të agjentëve, ballistëve e zogistëve, radhiten shokët **Isuf Gërvalla** (Lavdi paqin ai me shokët Bardhosh e Kadri!), e Ibrahim Kelmendi. "Ata (mendohen shokët Isuf e Ibrahim) në fakt janë mizorë të njohur (në gjuhën serbishte, "poznati siledija"), njerëz pa ndonjë qëllim..." pra, nga artikulli kuptohet se shokët si Isufi e Ibrahimi na qenkan "terroristë" e jo klika shoveniste serbomadhe e Beogradit. Dezinformimet, shpifjet e trillimet tendencioze nuk meritojnë analiza, pse edhe "kalemgjinjët" çetnikë dinë se nuk kanë shkruar të vërtetën, por dezinformime të qëllimta në luftë kundra revolucionarëve shqiptarë dhe popullit tonë.

Edhe më karakteristik është artikulli: "To su kriminalci" ("Këta janë kriminelë"). Dëshmorët **Tahir e Nebih Mehaj** "Ilustrovana Politika" dhe klika e Beogradit i quan "kriminelë" pse nuk patën ku të shkojnë përtej shtëpisë, por u mbrojtën si u ka hije trimave –

bashkluftëtarëve e nipave të Shote e Azem Galicës! Ata qëndruan dhe ranë heroikisht për të mos vdekur kurrë! Populli do i përjetëson në këngë e histori! Gjeneratat do flasin për qëndrimin heroik kundra njësive speciale të policisë së Beogradit dhe ushtrisë jugosllave, të armatosur gjer në dhëmbë me tanka, topa e helikopterë. Në këtë betejë dëshmorët Tahir e Nebih Mehaj gati shpaguan veten – do t'ishte dashur të ngordhin qindra nga tytë e trimave e jo dhjetëra, për të qenë të shpaguar. Asnjëherë luftëtarët e lirisë nuk mund dhe s'janë krahasuar me pushtuesit... Por, prap, jemi të kënaqur e krenar me këta dëshmorë të pavdekshëm në zemrën e popullit...!

### Përse vjen SHKA "Rugova"?

Nuk do mend të thuhet menjëherë se ardhja e "Rugovës" është pjellë e politikës shtypëse, diskriminuese e demagogjiko-mashtruese e klanit serbomadh, në vend "që të vranë natën e të qanë ditën" "të vranë natën e të këndon ditën". Në njërën anë ushtron terror të paparë fashist, duke vrarë, terrorizuar, dhunuar, arrestuar bijtë e bijat më të mirë të popullit, bile edhe fëmijtë, që për hiqgjë dënohen me shumë vite burgim të rëndë, kurse në anën tjetër detyrojnë turne "argëtimi"... që të mashtrojnë bijtë e popullit në kurbet, sikur në Kosovë s'ka ndodhur asgjë dhe se jeta atje është "normalizuar", sa vetëm "kërcehet" e "këndohet"...

Sa politikë të poshtër mashtruese ka armiku "ynë" i lig... Ai ende nuk ia ka kthyer popullit kufomat e të vrarëve në demonstrata e burgje që të varrosen sipas traditave, në njërën anë, kurse në anën tjetër përmes vojvodëve ndërmerr turne "argëtimi"... Bile, që t'i fshehin krimet e pafshehshme, klika shovensite e Beogradit (fashiste shkuar fashistëve, pse terrorin dhe mënyrat e tij që ajo ushtron në Kosovë, nuk kanë ditur t'i ushtrojnë as fashistët hitlerijanë...) u ka bërë gjyq të vrarëve, që fëmijët e farefisi të shpresojnë se të afërmit e tyre të vrarë gjenden ende të gjallë në burgje...!!

Ose, mos ndoshta kësaj radhe dojnë të festojnë "suksesin" e tyre, të arritur përmes vrasjes së trefisht të shokëve e vëllezërve tanë, bijve të popullit, Isufit, Kadriut e Bardhoshit... Ah! kriminelët, do festojnë kot – kanë rënë tre, janë ngritur me mijëra!

Na kujtohet viti i kaluar, kur nga salla e koncertit policia gjermane, me direktivën e udbashëve të konzullatit të Shtutgartit, nxori nga salla shokun Bardhosh. Çfarë ndodhi? Bashkatdhetarët u revoltuan shumë, kështuqë pas një proteste te policia gjermane, e cila nuk pranoi që shokët t'i sjell në sall të koncertit, u ngritën duke thirrur njëzëri mbi 500 veta "Kosova – Republikë"! ... dhe demoluan çdo gjë. Të nesërmen koncerti i Frankfurtit u mbajt me veglat e huazuara nga "shkitë".

### Kurtha e UDB-së – e cekët.

Vojvodë, more ti vojvodë! rrehe gjoks se do të mbash koncerte, pa guzuar të pengon asnjë "irredentist". Ke gabuar! Ne këndej nuk frikësohemi! Por kësaj radhe se kemi ndërmend të biem në kurthën tënde e të UDB-së. Ju aq u bën që mund të ketë gjakdërdhje. Për ju me rëndësi është kompromitimi i luftës sonë të drejtë, që pastaj, po të ndodhi ndonjë e papritur, shtypi e populli vendës të "bindet" në "vlerësimet" tuaja se ne jemi "terroristë", që në fakt jeni ju.

Kjo kurthë e pasuksesshme ngjanë në ato të Brukselit, ku keni futur në lojë "lojën" e kaubojve. Shkuat aq larg sa të vrisni punëtorë të pafajshëm në klub të punëtorëve. Populli ynë dhe bijtë e tij në kurbet dinë se kush janë armiqtë e vërtetë – ata jeni ju, ti vojvodë bashkë me farën tëndë, klika shovensite serbomadhe e Beogradit dhe mbarë tradhtarët shqiptarë të markës Sinan Hasani e Ali Shukriu me shokë!

Kësaj radhe vojvodë e udbashë, nuk kemi ndërmend të biem në kurthën tuaj, por mos harroni ditën kur do t'i jepni llogari popullit! Ne nuk jemi terroristë e kriminelë siç jeni ju. Ne jemi bijë e bija të popullit – do t'u presim me **bojkotime e urrejtje!** Në vend që të biem në

kurthat tuaja, si bijë e bija të popullit që jemi, i bashkangjitemi popullit, rinisë sonë revolucionare e intelegjencës përparimtare duke kërkuar të drejtat tona legjitime, ato të drejta që kërkoi populli në të gjitha qytetët e Kosovës (dihet, edhe në Preshevë, Tetovë e Gostivar, deri në Ulqin), duke larë rrugët me gjak, për të cilat të drejta dhanë jetën aq shumë dëshmorë e dhëshmore:

– Kosova - Republikë!
– Duam punë në vendlindje, pranë familjeve tona!
– Lirim pa kusht të të gjithë të burgosurve politikë shqiptarë!
– Rroftë populli ynë heroik!
– Lavdi dëshmorëve, që dhanë jetën për liri të atdheut!

Punëtorët shqiptarë në mërgim.

(Shkrim në 6 faqe A5, i shpërndarë nga Ibrahim Kelmendi, në maj 1982. Nënvizimet e këtij punimi ishin të autorit të saj, ashtu siç janë në origjinal në shkrimin e shpërndarë)

## 10. Në vend të përkujtimit me rastin e vdekjes së Ramë K. Nikçit

### Udhëheqës shumëvjeçar i Ansamblit autokton folklorik "Rugova" i cili afirmoi vlerat dhe kulturën shqiptare në botë

27 mars 2006 /TN (trepca.net)

Me rastin e vdekjes me 23 mars 2006 të udhëheqësit shumëvjeçar të ansamblit folklorik dhe autokton "Rugova" z. Ramë Kapllan Nikçi, në vend të përkujtimit për meritat e tij të mëdha që ka për rritën, punën dhe mbijetesën mbi 50 vjeçare të tij, për lexuesit e gazetës "Besa" po (ri)botojmë bisedën e bërë me të me 09. 10. 1999 në Shtuttgart të Gjermanisë:

Bisedoi: Rexhep ELEZAJ

**Të shkruash për ansamblin folklorik dhe autokton "Rugova", për këngët dhe vallet e bukura rugovase, për melosin karakteristik të tyre, për zërin e dalë nga fleta e njomë e ahut (që i fryhet ngjashëm si fyellit), për këngën me lahutë të lahutarit të famshëm të Rugovës Metë Rrustemi, për sharkinë, çiftelinë, për surlën me zërin e saj të thekshëm, për tupanin me rrathë druri, pastaj për veshjen kombëtare rugovase; tirqit, shokën, hërrkën, shallin e bardhë, xhamadanin, shaminë e kuqe me thekë lara-lara, fustanin e bardhë me rrudha, pështjellakun e madh dhe të vogël, opaktë e mëndafshta, qustekun e argjendit dhe këmishën e pëlhurës, etj, do të thotë se ke shkruar për historinë dhe kulturën e rugovasëve të cilët shekuj me radhë ia thanë këngës dhe valleve pa e ndërprerë traditën brez pas brezi.**



Ramë Nikçi

Ramë Kapllan Nikçi u lind me 3 mars të vitit 1928 në Shtupeq të Madh të Rugovës, në një familje bujare dhe me tradita të mëdha kombëtare. Që në moshë të re, si shumë rugovas, mbeti pa prindërit dhe jeta iu bë edhe më e rëndë. Në periudhën e pas LDB, me 14 qershor të vitit 1947, Rama bashkë me disa djem të Rugovës në Pejë shfaqi një program me këngë dhe valle të Rugovës, duke mos ditur se pikërisht këtë ditë i vuri themelet e një shoqërie kulturore, që më vonë u quajt ansambli folklorik autokton “Rugova”.

Për më shumë se 60 vite Ramë K. Nikçi në rrugën e tij kombëtare dhe artistike kultivoi vlerat e kulturës shqiptare të trevës së Rugovës si këngët, vallet dhe ritet e folklorit nga jeta e shqiptarit në këtë trevë si “Loja e jataganëve”, “Loja e shpatave”, “Loja e pushkëve”, “Vallja e kaçakëve”, “Vallja e nusës”, këngët kreshnike, këngët malësorçe, këngët e kositjes së livadheve si dhe shumë të tjera që u ruajtën me besnikëri dhe përkushtim të veçantë nga Ramë Nikçi dhe ansambli “Rugova”. Ai dhe ansambli të cilit i printe në mënyrën më burimore prezantojë para publikut, jo vetëm në të gjitha trevat shqiptare, por edhe në shumë metropole evropiane vallen, këngën dhe kërcimin burimor dhe shumë karakteristik të rugovasëve, si lojën me jatagana, kërcimet në ajër si dhe shumë vlera tjera të folklorit rugovas.

Ansambli “Rugova” nën udhëheqjen e Ramë Kapllanit ka marrë pjesë në shumë festivale kombëtare dhe ndërkombëtare të folklorit ku gjithmonë është shquar për punën dhe krijimtarinë artistike, i cili bashkë me ansamblin për 50 vjet pune janë laureatë të pesë medaljeve të arta, 11 të argjendta, 25 të bronzta, 350 mirënjohjeje, Shpërblimit të Dhjetorit, Shenjës së Artë si dhe shumë mirënjohjeve dhe dekoratave tjera. Ka kryer Shkollën e lartë si dhe dy vite të Fakultetit juridik në Prishtinë me 1963, ndërsa gjatë jetës së tij ka kryer funksione dhe punë të ndryshme në Rugovë dhe Pejë, pranë aktivitetit dhe punës së pa lodhur si udhëheqës i ansamblit.

Që në fillim z. Ramë Nikçi na e tërhoqi vërejtjen se bisedën tonë me të rreth punës dhe aktivitetit të ansamblit “Rugova”, udhëheqës i të cilit është, nuk e konsideron të plotë, sepse siç tha, kur të shkruhet për këtë ansambël duhet që së paku të jenë prezent tre gazetarë që vijnë ekskluzivisht nga treva e Rugovës, ngase i njohin më mirë se të tjerët adetet dhe traditat burimore të kësaj treve.. Megjithatë, ne arritëm që nga thesari i madh i punës dhe aktivitetit të tij kombëtar dhe kulturor të shkëpusim sado pak nga përvoja e tij për rritën dhe aktivitetin e këtij ansambli që nga themelimi.

Nga kjo kulturë atdhetare, nga vlerat dhe traditat e lashta shqiptare mijëvjeçare të trevës së Rugovës do lind me 1947 dhe do t’i mbijetojë të gjitha furtunat deri me çlirimin e Kosovës me 12 qershor 1999 ansambli folklorik dhe autokton “Rugova”, i cili për mbi 50 vite rresht do t’i këndojë dhe vallëzojë lirisë së Kosovës, jehona dhe zëri i të cilit bujshëm do të shpërndahen anë e kënd Kosovës dhe deri në Angli, Francë, Gjermani, Itali, Kroaci, etj.

Vargu i valltareve dhe valltarëve të këtij ansambli gjithnjë të veshur me teshat më të bukura kombëtare, me flamur kombëtar në dorë të qëndisur me thek ngjyrë ari kur ia thonin këngës dhe valleve në dasmat e Kosovës ta merrte mendja se po dilnin si “tigrat” nga nëntoka e Bjeshkëve të Rugovës, për t’ia futur me pamjen e tyre madhështore tmerrin armiqve dhe për

t'iu dhënë të kuptojnë barbarëve serb të instaluar në Kosovë se kënga dhe vallja shqiptare do mbetën prore të gjalla mbi këto troje të lashta iliro-dardane.



Ansambli folklorik autokton "RUGOVA"

Kështu fletë me mallëngjim sot njeriu, artisti, udhëheqësi dhe njëri ndër aktorët kryesor i këtij ansambli z. Ramë Nikçi, i cili për më tepër se 50 vite do ta udhëheq këtë ansambël për ta ndihmuar rritën e tij, mbijetesën si dhe kultivimin, ruajtjen dhe afirmimin e vlerave kulturore të këngës dhe valles shqiptare nga treva e Rugovës.

Të gjitha rekuizitat të ansamblit "Rugova" siç janë medaljet, jataganat, shpatat, veglat muzikore, albumet e shumta me fotografi, arkiva, etj, nëse i kanë shpëtuar barbarisë serbe mund të gjenden në Shtëpinë e kulturës në Pejë, tani nën udhëheqjen e KFOR-it, thotë i brengosur ky tribun i valles shqiptare dhe kur më bie ndërmend se sa libra (mbi 1000 copë) dhe dokumentacion me vlera kombëtare janë djegur në shtëpinë time në Pejë, më vije të pëlcas nga dhimbja për to, posaçërisht, sepse në mesin e tyre ishte një material i rrallë të cilin e kisha siguruar me mund të madh nga një malazez ku bëhej fjalë me emër dhe mbiemër për kolonizatorët malazias në Kosovë, d. m. th. për zullumin që kishin bërë ndaj shqiptarëve. Po ashtu më janë djegur tëra materialet e mbledhura dhe të sistemuara në shirita të këngëve patriotike dhe kreshnike të Rugovës..!!

Gjithmonë ndjehesha krenar, thotë më tutje z. Ramë Nikçi, që Zoti më kishte dhënë talentin e kërcimit të valleve tipike të Rugovës dhe isha tepër i lumtur se përmes hedhjes së valles mund t'i kontribuoja kultivimit të më tejmë të artit kaq të lashtë shqiptar, ndaj në kujtesën time më kanë ngelur shumë çaste të cilat nuk mund t'i harrojë kurrë, por edhe aso rastesh kur ndjehesha shumë i prekur siç ishte momenti kur merrnim pjesë nëpër festivale ndërkombëtare të folklorit e që në shumicën e rasteve shikuesit nuk e dinin se jemi shqiptarë nga Kosova, duke menduar se jemi maqedonas, e bile edhe në Zagreb më 1976 kur me një rast i veshur në tesha kombëtare po merrja përshtypjet nga disa shikues në pyetjen që i bëra një çifti bashkëshortor që të dytë ishin inxhinierë, se a dinin nga jemi, m'u përgjigjen: nga Maqedonia dhe as që e dini se ku gjendej Kosova..!?

Sot lirisht mund të them se ansambli "Rugova" gjatë periudhës më të vështirë nën okupimin e egër dhe të gjatë serb ka luajtur rol të rëndësishëm në afirmimin e kulturës shqiptare

në Ballkan, por edhe më gjerë në Evropë, e këtë më së miri e dëshmojnë medaljet e shumta të fituara si dhe zënia e vendit të parë në disa festivale folklorike ndërkombëtare.

Ansambli ynë ishte ndër të parat që si mysafire e vizitojë Shqipërinë me 1972 duke e prezantuar këngën dhe vallen rugovase në shumë qytete të shtetit amë. Për hir të historisë dhe vlerës artistike të valles rugovase më duhet të përmendi njërin nga figurat më shembullore të ansamblit "Rugova" të ndjerin Ramë Elezin-Lajqin (vdiq në vitin 1981), i cili ishte njëri ndër shtyllat kryesore të ansamblit pa të cilin vlerat dhe sukseset tona do të ishin të mangëta, sepse ishte njeri me talent të rrallë për kërcimin e valles burimore rugovase, sidomos shquhej me lojën e "Valles me shpata" (gjithmonë e luanim së bashku në dysh) dhe ishte pa dyshim simboli më autokton i ansamblit tonë, ndërsa me veshjen e tij tipike rugovase (me shall dhe tirqi) të cilët nuk i zdeshi kurrë derisa vdiq, i jepte pamje magjepse vetë ansamblit si dhe qytetit të Pejës ku jetoi, por edhe krejt Kosovës.

Pas vdekjes së tij nuk mund të gjeja një valltar të ngjashëm, ngase e veçanta e kërcimit tonë ishte se unë vallëzoja duke e përcjellë taktin e zërave të veglave muzikore, kurse ai vallëzonte me stilin e tij të veçantë pa e humbur kurrënjëherë ritmin e përbashkët të valles që luanim. Janë përpjekur shumë koreograf që ta bëjnë koreografinë e stilit të vallëzimit tonë, por nuk ia kanë dalë, thotë Ramë Nikçi, kurse sa i përket sukseseve të ansamblit tonë ato janë meritë e gjithë rugovasëve të cilët e ndihmuan atë pa rezervë, qoftë duke dhënë valltarë dhe valltare të talentuara që e mundësonin pjesëmarrjen tonë me sukses nëpër festivale të shumta.




Pjesëmarrjen e fundit jashtë Kosovës e kishim në një festival në Ulqin më 1994 të cilin na e mundësojë LDK-ja, por tretmani ynë këtu ishte tepër i ultë nga ana e organizatorit (malazias), për shkak se emri i ansamblit tonë ishte i njëjtë me mbiemrin e kryetarit Ibrahim Rugova i cili në atë kohë ishte bërë "therrë në sy" për organet shovene serbo-malazeze, por megjithatë neve kënduam këngë patriotike dhe luajtëm valle sipas repertoarit tonë. Mjerisht, aty e tutje puna e ansamblit tonë u vështirësua aq shumë sa u detyruam ta ndërprejmë aktivitetin.

Tani kur Kosova është e çliruar, ansambli ynë serish do t'ia thotë këngëve dhe valleve shqiptare edhe më të bukura, pohon në fund të bisedës tonë z. Ramë Nikçi.

**(Bisedoi: Rexhep Elezaj, më 9 tetor 1999 në Shtutgart; U ribotua në trepca.net, 27 mars 2006)**

## 11. Gjyshi Ibush, Daja Ramadan, dhe Garipi djali i Dajës Ramadan

Ibrahim Kelmendi: *"– Ju kërkoj juve, Zotëri Fekir Dalana, – iu përgjigj sërish me qetësi të madhe Mirani.*

*– Unë nuk jam Fekir Dalana dhe juve nuk po ju njoh fare! – foli ai pa mundur ta fshihte gënjeshtrën e tij naive.*

*– Si nuk më njihke? Jam nipi i ish-kolegut tënd, Dajës Ramadan. Tani sigurisht po të kujtohem. Sa herë ju kam bërë kafe kur vinit te gjyshi* ***Ibush*** *dhe ju me lavdëronit për kafet e mira.*

*– O, po, më fal, urdhëro nipash, tani po më kujtohesh, – tha Fekiri duke hapur derën dhe duke u munduar të zgërdhihej sikur po i bëhej qejfi që po e vizitonte Mirani.*

*Mirani u fut brënda duke u bërë se ishte i gëzuar që po takonte pas shumë vjetëve kolegun e shokun e* ***Dajës Ramadan****. U përqafuan dhe Mirani zuri vend aty ku e drejtoi mikpritësi. Ndërruan fjalët përshëndetëse duke pyetur për hallet, jetën etj. Pastaj Mirani hapi bisedën për qëllimin e ardhjes.*

*– Zotëri Fekir Dalana, të përgëzoj që je zgjedhur kryeredaktor i Organit "Besa Shqiptare". Më është bërë qejfi që jeni zgjedhur pikërisht Ju, meqë ju njoh që moti për patriot. Për ju më ka folur shumë Daja Ramadan dhe bile, kur fola para dy ditëve me të në telefon, më porositi t'ju përshëndes, meqë i tregova se do të vija në Vjenë."* (Atentatet, Prishtinë 2007, faqe 75)

Ibrahim Kelmendi: "*Në Mynhen jemi duke u përpjekur të marrim Klubin "Rilindja". Ai vazhdon të jetë nën tutelën e konsullatës jugosllave. Aty ka qëlluar djali i Dajës Ramadan, Garipi, kryetar, për të cilin ke dëgjuar."* (Atentatet, Prishtinë 2007, faqe191)

Ibrahim Kelmendi: *"Fillimisht dëshiroj të shpreh vlerësimin se atë* ***"raport"*** *nuk e ka shkruar fare Jusufi, meqë nuk është në fahun, në germën dhe në frymën e tij. Po ta kishte shkruar vërtet ai, nuk do te ngurroja ta diskreditoja, edhe për së vdekuri, për të pabesë e intrigant."* (Bedri Islami, Lëvizja, Tetovë 2012, f.115)

Jusuf Gërvalla (raport): "*Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Popullor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980. ...*

*Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës. I biri i këtij Ramës ndodhet me punë në Mynhen dhe ka qenë aktivist i dalluar, madje edhe kryetar klubi në Mynhen."* (www.albaniapress.com, 2 tetor 2011; Faridin Tafallari, Kur Jusuf Gërvalla shkruante)

## 12. Arkivi më i saktë është vetë populli

**"Salih Kabashi**: Një ditë do të hapen dosjet, ku secili do të ketë mundësi, si në Slloveni, bie fjala, që të ketë qasje në dosjen që ka mundur ta ketë mbajtur për të Shërbimi i Sigurimit të Shtetit, apo ndryshe policia politike komuniste e njohur si UDB. Kur kihet parasysh se dosje të tilla janë bartur në Beograd, a mund të imagjinosh rrëmujën që do të shkaktonte kthimi i tyre në Kosovë dhe hapja e tyre për publikun?

**Ibrahim Kelmendi**: Nëse Beogradi nuk do të demokratizohet, atëherë duhet pritur se dosjet do të manipulohen e do të sajohen, varësisht nga nevojat politike ditore, për t'i shërbyer politikës se tyre nacionaliste. E vetmja mundësi për t'ju kundërvënë spekulimeve hileqare është trajtimi i tyre nga ekspertët. Zhvillimi i shkencës ka shkuar deri atje, sa të konstatojë saktësisht se kur është përpiluar një shkresë, gjegjësisht një dosje. Prandaj dhe duhet të shfaqim rezerva, kur ata do t'i servirin. **Kurse arkivi më i saktë është vetë populli, pasi secilit individ ai ia di veprimtarinë konkrete, që do thotë se rrethi ku jam angazhuar unë e di se cili kam qenë dhe çfarë kam bërë....** "(Republika, prill 2007)

## 13. DO TA DISKREDITOJA, EDHE PËR SË VDEKURI, PËR TË PABESË E INTRIGANT



"Bedri Islami (në forografi): *Pas botimit të romanit "Atentatet" ju u ndodhët edhe një herë në dy kahe: në përgëzimin e shumë prej atyre që i kishin përjetuar ngjarjet bashkë me ju, si Saime Isufi apo Mustafe Xhemajli, por edhe në ciklimin e radhës së sulmit ndaj jush, nëse mund ta quaj kështu. Mes të tjerave, në një material, i cili po përhapet tashti, nuk e di nëse është i saktë, bëhet fjalë për lidhjen fisnore me Ramë Nikqin ose Ibërdemaj, i cili, siç e cilëson Xhafer Durmishi, me siguri "analisti" më i zellsheim i romanit tuaj, ishte agjent i UDB-së.*

Ibrahim Kelmendi: - Pas botimit të romanit "Atentatet" ka pasur vërtet reagime të lojllojshme dhe, me thënë të drejtën, më kanë gëzuar. Ato ishin një dëshmi se nuk e kisha shkruar vetëm sa për ta shkruar. Pas dy muajve romani u shit dhe shpesh ndihem keq kur të interesuarit e tjerë e kërkojnë dhe unë nuk kam asnjë kopje. Shtëpia botuese "Toena" e Tiranës ka premtuar ta ribotojë.

Tani ka shkruar një reagim të gjatë Xhafer Durmishi, ish-bashkëveprimtar, njëkohesisht ish-kundershtari imi. Sa për shembullin që sollet ju për sqarim, unë nuk do t'i isha hidhëruar fare Xhaferit, sikur të kishin qenë shpifje të tij autentike, ngaqë ndaj tyre kam krijuar imunitet. Tani më shqetëson fakti se ato shpifje i vishen Jusufit, të cituar në bazë të një "raporti" që gjoja ai i paskësh dërguar Sabri Novosellës. Fillimisht dëshiroj të shpreh vlerësimin se atë "raport" nuk e ka shkruar fare Jusufi, meqë nuk është në fahun, në germën dhe në frymën e tij. Po ta kishte shkruar vërtet ai, nuk do të ngurroja ta **diskreditoja, edhe për së vdekuri, për të pabesë e intrigant**.

Kohë më parë, në Maqedoni, më ka rastisur të ballafaqohem me **materiale të falsifikuara, që ca kriminelë i shpëmdanin** për "dosje". Ishin sajuar për të diskredituar Ali Ahmetin, Fazli Veliun, Musa Xhaferin, bashkeveprimtarët tanë shumëvjeçar! Edhe ky "raport" me ngjan me ato falsifikime. Mjafton të them se Jusufi e ka ditur shumë mirë kush ishte Ramë (Idriz) Ibërdemaj, prandaj nuk ka pasur nevojë të hamendësohej nëse ishte Ramë Ibërdemaj apo Ramë Nikqi. Ai ka qenë i informuar për Ramë Ibërdemajn, meqë është shkolluar në Pejë dhe e ka ditur se Rama ishte djali i axhës së nënës sime.

Në vitin 1980, në Mynih, unë dhe Jusufi patëm një zenkë serioze. Unë kisha shkuar aty me katër bashkëveprimtarë për të marrë pjesë në tubimin e klubit "Rilindja" që të pengonim zgjedhjen e Ganisë, djalit të Ramë lbërdemajt, si kryetar të atij klubi famëkeq. Asnjëri nga ne nuk e dinte nëse do ta takonim në klub Bali Rexhbogajn nga Bllagaja e Pejës. Pas tubimit ai këmbënguli të na merrte mysafirë. Sapo arritëm para pallatit ku banonte Baliu, takuam Jusufin dhe Bardhoshin. Ata ishin aty për vizitë te Misin Mavraj i Staraderanit të Istogut. Papritmas Jusufi dyshoi mos po e survejoja. Në këtë aspekt ai ishte tejet i papërvojë dhe ndonjëhere bëhej si fëmijë. I shpjegova pse ishim në Mynih dhe përse ndodheshim pikërisht aty dhe se survejimi

nuk bëhej në atë mënyrë. Pra, e mori vesh se kishim vajtur të pengonim zgjedhjen si kryetar klubi të djalit të Ramë Ibërdemajt. Edhe më herët, edhe aty, edhe më vonë, kemi biseduar bashkë për dyshimet ndaj Ramë Ibërdemajt, se kishte qenë argat i UDB-së dhe Jusufi, si gazetar, i shkolluar në Pejë, dinte për ato dyshime. Tashmë dinte edhe për lidhjet tona farefisnore. Dihet, dajën nuk e zgjedh dot. Jusufit nuk do t'i kishte shpëtuar kjo lajthitje, edhe po të kishte qenë i pabesë dhe intrigant dhe të kishte përpiluar të tillë "rapott" kaq diskreditues, së pari për veten e tij. Pra, kjo lajthitje është prodhuar nga falsifikuesi, i cili ngjan të jetë vetë Xhafer Durmishi, meqë e citon rreth 100 herë atë "raport" në "librin" e tij, me titull hileqar e intrigues: "Lëvizja e Jusuf Gërvallës".

Në të njëjtin "raport" është edhe një lajthitje tjetër për Sadik Blakajn, që e ka prodhuar falsifikuesi i painformuar. Jusufi ka qenë i informuar saktësisht për të, e ka njohur edhe personalisht dhe nuk do t'i kishte raportuar "udhëheqësit" Sabri Novosella kaq dezinformueshëm. Për pjesët e tjera të "raportit" e "letrave" të Jusufit, gjithsesi të falsifikuara, ndoshta do të reagoj më shtruar në një rast tjetër.

Po ta kishte publikuar këtë "libër" Xhafer Durmishi para se ta kisha shkruar romanin "Atentatet", sigurisht, unë do ta kisha mënjanuar Ramë Ibërdemajn si personazh të romanit, për inat të Xhaferit. Prandaj, edhe për inat të Xhaferit, me këtë rast dua t'u kërkoj falje fëmijeve të respektuar të dajës Ramë, pse e kam diskredituar atë në roman si të dyshimtë për bashkëpunëtor të UDB-së. Vetëm për Haki (Ramë) Ibërdemajn, të cilin një spiun i UDB-së e vrau në Bruksel, sigurisht që kisha dhënë një tren me xhafera që të mos e vrisnin, sepse e kishte dëshmuar veten në demonstratat e vitit 1981 në Prishtinë dhe gjatë angazhimit të tij patriotik në Bruksel si trim e patriot i devotshëm!" (Bedri Islami, Lëvizja, Tetovë 2012, faqe 113-117)

## 14. Letër nga Donika Gërvalla për Faridin Tafallarin, 7 tetor 2013

Mirëdita

Isha sot këtu për të marrë dokumentet e Babait, mirëpo nuk ju gjeta në shtëpi. Ju lutem më`i dërgoni dokumentet në adresën time:

Donika Gërvalla
Ungartenstr. 9
53229 Bonn

Shpenzimet e transportit kuptohet që i marr përsipër unë. Aty ka dokumente që janë pjesë e dosjes hetimore rreth vrasjes, prandaj ju lus që për të mos rrezikuar apo ngadalësuar këto hetime të më dërgoni të gjitha dokumentet dhe as të mos botoni diku ndonjë pjesë të tyre dhe as mos t`ia tregoni më askujt. Ato dokumente janë pronë e familjes Gërvalla, dhe i duhen kthyer asaj. Unë erdha miqësisht për te marrë dokumentet dhe për të shkëmbyer dy fjalë. Ju lutem më dërgoni dokumentet brenda 10 ditëve të ardhshme.

Shumë të fala edhe familjes. Donika Gërvalla (nënshkrimi)

P.S.

Shënimi i F.T.) Letër e lën në kutin e postës në adresën time pa emrin e pranuesit (timin) në Horberstr.37, 72221 Haiterbach, dhe pa zarfe, në dy letra A5 e shkruar në dorëshkrim, pa datë!? Këtë letër e mora në mëngjesin e të hënës me datë, 07.10.2013

(U botua për herë të parë nga Faridin Tafallari, në përmbledhjen me titull: Letra, që më kanë dërguar Suzana dhe Donika Gërvalla, www.albaniapress.com, 8 nëntor 2013)

==========================================================

Libra nga Xhafer Durmishi – Skenderi i Shtutgartit, për Rilindasit e Shtutgartit
01. Protesta e Aspirata – Tetor 2006
02. Lëvizja e Jusuf Gërvallës- Tetor 2011
03. Zëri i popullit dhe Zëri i Jusuf Gërvallës-Nëntor 2011
04. Të fala s'po na çojnë asnjëherë-Dhjetor 2011
05. Nuk pyesin për çmimin e lirisë-Mars 2012
06. Pa taktizime-Prill 2012
07. Në rrethin e Shtutgartit-Shtator 2012
08. Fakte për Lëvizjen e Jusuf Gërvallës-Tetor 2012
09. Luga dhe Lugina-Dhjetor 2012
10. Filharmonia e Jusuf Gërvallës-Janar 2013
11. Shokët dhe Jusuf Gërvalla-Shkurt 2013
12. Fjalori i Lëvizjes së Jusuf Gërvallës-Maj 2013
13. Argatët agresiv-Maj 2013
14. Pa trazime-Qershor 2013
15. Skena-Qershor 2013
16. Emër që u bë traditë-Qershor 2013
17. Jusuf Gërvalla dhe Liria-Korrik 2013
18. Testamenti-Gusht 2013
19. Ilustrime-Janar 2014
20. Vepra e Jusuf Gërvallës-Janar 2014
21. Ti ia ke besuar arkivin e Jusufit-Korrik 2019
22. Qendra Jusuf Gërvalla-Janar 2023
23. Lufta për liri në letrat e Jusuf Gërvallës, Mars 2024
24. Dëshmi e Dëshmorë, Janar 2025
25. HAPËSIRA, KOHA dhe Drita e Jusuf Gërvallës, Shkurt 2025
26. Referenca – Burime I-1979-1983
27. Referenca – Burime II-1982-1985

Jusuf Gërvalla: "*Kështu e pata kuptuar më në fund edhe zgjedhjen e Shpendit (Skenderit-shën im) dhe timen në Komitetin Qendror*." (14 janar 1981)

**Shënime për autorin**

Xhafer Durmishi-Skenderi ka lindur në maj 1958 në fshatin Stanoc të poshtëm të komunës së Vushtrrisë. Nga arsimtarët e vetë të shkollës fillore angazhohet në organizatën "Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi". Në vitet 1977-1981 ka studiuar në Fakultetin Xehtaro-Metalurgjik në Mitrovicë, në degën e Teknologjisë. Nga korriku 1981 gjendet pranë Vëllezërve Gërvalla në Shtutgart. Pas atentatit të 17 Janarit 1982, në mars 1982, falë dhuntive të natyrës, diturive dhe cilësive të ndërgjegjes e tij, me kërkesën e rrethit të Jusuf Gërvallës vazhdon redaktimin e asaj gazete që më parë e kishte redaktuar Jusuf Gërvalla. Fillimisht në redaktimin e plotë dhe në përgatitjen teknike të gazetës kryesore të Lëvizjes për Republikë punon gjer në mars 1983. Pas një qëndrimi prej 100 ditësh në Paris, në korrik 1984 vendoset në Suedi. Në korrik 1985 shërbimet e tij për çështjen apo në emër të çështjes shqiptare, nga rrethi që i kishte qëndruar afër, nuk konsiderohen të nevojshme dhe lirohet nga detyrimet e obligimet e organizuara politike. Vepra e tij pas vitit 1985 e ka bazën në detyrimet e ndërgjegjes. Është përkthyesi i parë i autorizuar për përkthime në mes suedishtes e shqipes. Merret me përkthime. Është njohës i mbi njëzet e pesë gjuhëve të huaja.

==========================================

**XHAFER DURMISHI-SKENDERI Janar 2014-Shkurt 2026**